



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

N^o 2842/1 Prot.,

Tiranë, më 03/12 /2018

TË GJITHA DEGEVE DOGANORE

TË GJITHA DEPARTAMENTEVE

TË GJITHA DREJTORIVE NË DPD

Lënda: Njoftim Udhëzimi

Bashkëlidhur po Ju dërgojmë Udhëzimin Nr.15 datë 03/12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”.

Të merren masat e menjëherëshme për njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Duke Ju falenderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Belinda IKONOMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 28421 Prot.

Tiranë, më 03 12 /2018

UDHËZIM

Nr. 15 datë 3 12. 2018

**MBI EVIDENTIMIN, KONTABILIZIMIN
DHE RIKUPERIMIN E DETYRIMEVE TE PAPAGUARA DOGANORE DHE TE
AKCIZES**

Ne zbatim te neneve 72 deri 117, nenit 280 të ligjit nr. 102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës se Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, VKM nr. 651, date 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor”, ligjit Nr 92/2014 “Per Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit Nr.9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, ligjit Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjit Nr.9900, datë 10.4.2008 “Për Rezervat Materiale të Shtetit”.

Me qëllim zbatimin korrekt te dispozitave mbi borxhin, penalitetin dhe kamatëvonesat dhe unifikimin e praktikave lidhur me procedurat për evidentimin, kontabilizimin, rikuperimin, rimbursimin dhe faljen e tyre, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave,

U D H Ë Z O N:

I. PËRKUFIZIME:

Për qëllim të këtij udhëzimi me termat e mëposhtëm do të kuptojmë:

- Borxhi Doganor:** Për qëllime të nenit 6, pika 16, të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, është detyrimi që ka një person për të paguar shumën e detyrimeve të importit (borxh doganor importi) ose shumën e detyrimeve të eksportit (borxh doganor eksporti) të cilat zbatohen përmallra të caktuara, sipas legjisacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Borxhi i Akcizës:** është detyrimi që ka depozituesi i miratuar, pritësi dhe dërguesi i regjistruar, përfaqësuesi fiskal ose çdo person tjetër, për të paguar shumën e detyrimeve të akcizës, që zbatohet përmadje të produktet që i nënshtron detyrimit të akcizës, penalitetet dhe kamatvonesat.

- 3. Detyrime te papaguara:** është shuma e borxhit doganor te papaguar apo shuma e borxhit te akcizës, gjobat e aplikuara dhe kamatë vonesat.
- 4. Debitor:** Për qëllime të nenit 6 pika 16, neneve 72 – 117, te Kodit Doganor, (ligji 102/2014), të ndryshuar, nenit 2 e në vijim te ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është çdo person që ka detyrim për të paguar borxin doganor dhe/ose borxin e akcizës, gjobat e aplikuara dhe kamatë vonesat.
- 5. Deklarues:** Për qëllime te pikës 15 të nenit 6, neneve 72, 81, 250, 280 e në vijim të Kodit Doganor, është: personi që bën deklarimin në doganë me emrin e vet (përfaqësim i drejtpërdrejtë) ose personi që bën deklarimin në doganë në emër të tij, por për llogari të një personi tjeter (përfaqësim i tërthortë).
- 6. Sekuestrim:** është mjeti për garantimin apo pagimin e detyrimeve te papaguara. Ai vendoset përkundrejt një urdhri te arsyetuar dhe procesverbalit përkatës.

Sekuestrimi mund te jetë:

- a) **Preventiv**, qe vendoset si peng, me qellim qe te shmange rrezikun për mosgjendjen me vone te sendit për sekuestrim ekzekutiv apo konfiskimin e tij si dhe për te renduar, zgjatur kohen e likujdimit te detyrimeve te papaguara;
 - b) **Konservativ**, qe vendoset kur ka arsyte te bazuara, apo dyshime te arsyetuara për te menduar se nuk ka garanci për te paguar detyrimet e papaguara ;
Sekuestroja konservative shnderohet ne sekuestro ekzekutive kur vendimi ka marr formë te prerre dhe eshte i detyrueshem per zbatim.
 - c) **Ekzekutiv**, qe vendoset per ekzekutim te menjëherëshëm te vendimit, nëpërmjet kalimit ne posedim te Shtetit te sendit te sekuestruar dhe shitjes te tij për pagimin e detyrimeve te papaguara.
7. **Konfiskim:** Për qëllime te zbatimit të Kodit Doganor si dhe të ligjit nr. 61/2012 “Per Akcizat në RSh”: është kalimi ne pronësi te shtetit te sendit te debitorit me qellim ekzekutimin e vendimit për detyrimet e papaguara.
 8. **Rimbursim:** Për qëllime të nenit 6, pika 28, të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor I Republikës së Shqipërisë”, është kthimi i një shume detyrimi importi ose eksporti që është paguar.
 9. **Falje:** Për qëllime të nenit 6, pika 29, të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor I Republikës së Shqipërisë”, është heqja dorë nga detyrimi për të paguar një shumë detyrimi importi apo eksporti që nuk është paguar.

II. DETYRIMET E PAPAGUARA DHE DEBITORET

1. Importi

1.1. Çlirimi për qarkullim të lirë dhe lejimi i përkohshëm

1.1.1. Ne zbatim te nenit 72, të Kodit Doganor, detyrimet e papaguara te importit lindin nëpërmjet:

- a) çlirimit për qarkullim të lirë, përfshirë regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use);
- b) lejimit të përkohshëm, me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit..

1.1.2. Borxhi Doganor lind në datën e pranimit të deklaratës.

1.1.3. Debitor është deklaruesi. Në rastin e përfaqësimit të tërthortë (me agjent doganor), është gjithashtu debitor personi për llogari të të cilit bëhet deklarata doganore.

Kjo do të thotë që, kur deklarata doganore lidhur me një nga regjimet e përmendura në shkronjën a) dhe b) te pikës 1.1.1 hartohet në bazë të një informacioni që tregon se një pjesë ose e gjithë shuma e detyrimeve të importit që duhen paguar nuk është vjelë, personat që e kanë dhënë informacionin e nevojshëm për hartimin e deklaratës dhe ata që provohet se ishin në dijeni ose objektivisht duhej të ishin në dijeni se ky informacion ishte i rremë, janë debitorë.

1.2. Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërmbushjes

1.2.1. Në zbatim të nenit 74 për mallrat që u nënshtrohen detyrimeve të importit, një borxhi doganor në import lind nëpërmjet mospërmbushjes së:

- a) një prej detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor, në lidhje me futjen e mallrave joshqiptare në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, shmangien e tyre nga mbikëqyrja doganore ose në lidhje me lëvizjen, përpunimin, magazinimin, magazinimin e përkohshëm, lejimin e përkohshëm ose shkatërrimin e mallrave të tillë brenda këtij territori;
- b) një prej detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor, që ka të bëjë me përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
- c) një kushti që rregullon vendosjen e mallrave joshqiptare nën një regjim doganor ose dhënien, për shkak të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave, e përjashtimit ose të një reduktimi të detyrimit të importit.

1.2.2. Momenti, në të cilin lind borxhi doganor është:

- a. momenti kur nuk plotësohet ose pushon së plotësuari detyrimi, mospërmbushja e të cilit sjell lindjen e borxhit doganor; ose
- b. momenti kur pranohet një deklaratë doganore me qëllim vendosjen e mallrave nën një regjim doganor e kur, për të cilën më vonë, (aposteriori), konstatohet që nuk është përbushur kushti që rregullon vendosjen e mallrave nën atë regjim ose dhënien e një përjashtimi nga detyrimi ose reduktimin e një detyrimi importi për shkak të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use).

1.2.3. Në rastet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1.2.1, debitor është:

- a. çdo person të cilil i ishte kërkuar plotësimi i detyrimeve në fjalë;
- b. çdo person, ndaj të cilil provohet se kishte dijeni ose objektivisht duhet të kishte dijeni që nuk ishte përbushur një detyrim sipas legjislacionit doganor dhe që veproi në emër të personit, i cili ishte i detyruar të

- përmbushte detyrimet apo mori pjesë në veprimin që solli mospërmbushjen e detyrimit;
- c. çdo person i cili blen ose mban mallrat në fjalë, ndaj të cilat provohet se kishte dijeni ose objektivisht duhej të kishte dijeni në momentin e blerjes ose marrjes së mallrave që detyrimi, sipas legjislacionit doganor, nuk ishte përmbushur.
- 1.2.4. Në rastin e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1.2.1, debitor është personi, të cilat i kërkohet të përmbushë kushtet që rregullojnë vendosjen e mallrave nën një regjim doganor ose deklarimin doganor të mallrave nën atë regjim apo kushtet që rregullojnë dhënien e një përjashtimi a të një reduktimi nga detyrimet e importit për shkak të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave.

Kur një deklaratë doganore, e hartuar për një prej regjimeve doganore, sipas përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 1.2.1, dhe çdo informacion i kërkuar sipas legjislacionit doganor, në lidhje me kushtet që vendosin mallrat nën atë regjim doganor, që u është dhënë autoriteteve doganore, çojnë në mosmbledhjen e të gjithave ose të një pjesë të detyrimeve të importit, personi, i cili jep këtë informacion për hartimin e deklaratës dhe ndaj të cilat provohet se kishte dijeni ose objektivisht duhej të kishte dijeni që një informacion i tillë ishte i rremë, gjithashtu është debitor.

2. Eksporti

2.1. Eksporti dhe përpunimi pasiv

- 2.1.1. Në zbatim të nenit 76 të Kodit Doganor, një borxh doganor në eksport lind nëpërmjet vendosjes së mallrave, që u nënshtrohen detyrimeve të eksportit, nën regjimin e eksportit ose nën regjimin e përpunimit pasiv.
- 2.1.2. Borxhi doganor lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore.
- 2.1.3. Debitor është deklaruesi. Në rast të përfaqësimit të tërthortë, debitor është gjithashtu personi, për llogari të të cilat është bërë deklarimi doganor.

Kur një deklaratë doganore është hartuar duke u mbështetur në informacion, i cili sjell mosmbledhjen e të gjitha ose të një pjesë të detyrimeve të eksportit, personi, i cili ka dhënë këtë informacion për hartimin e deklaratës dhe kishte dijeni apo objektivisht duhej të kishte dijeni që një informacion i tillë ishte jo i saktë, gjithashtu është debitor.

2.2. Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërmbushjes

Në zbatim të nenit 77 të Kodit Doganor,

- 2.2.1. Për mallra që u nënshtrohen detyrimeve të eksportit, një borxh doganor lind nëpërmjet mospërmbushjes së:
- a) një prej detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor për daljen e mallrave;
 - b) kushteve, në të cilat mallrat janë lejuar të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit.

2.2.2. Momenti i lindjes së borxhit doganor është:

- a) momenti kur mallrat dalin efektivisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pa një deklarim doganor;
- b) momenti kur mallrat mbërrijnë në një destinacion të ndryshëm nga ai për të cilin ato janë lejuar të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit;
- c) nëse autoritetet doganore nuk janë në gjendje të përcaktojnë momentin e përmendor në shkronjën "b", përfundimi i afatit kohor të vendosur për dhëni e provës që vërteton se janë përbushur kushtet përfitimin e këtij përjashtimi.

2.2.3. Në rastet e parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, debitor është:

- a) çdo person, të cilit i ishte kërkuar plotësimi i detyrimeve në fjalë;
- b) çdo person, i cili kishte dijeni ose objektivisht duhej të kishte dijeni që detyrimi në fjalë nuk ishte përbushur dhe që veproi në emër të personit, i cili ishte i detyruar të përbushë detyrimin;
- c) çdo person, i cili mori pjesë në veprimin që çoi në mospërbushjen e detyrimit dhe që kishte dijeni ose objektivisht duhej të kishte dijeni që deklarata doganore nuk është depozituar, por duhej të ishte depozituar.

2.2.4. Në rastet e përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, debitor është çdo person, të cilit i kërkohet të plotësojë kushtet, në të cilat mallrat u lejuan të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit

3. Dispozita të veçanta në lidhje me mallrat joorigjinuese dhe trajtimin tarifor favorizues

3.1. Në zbatim të nenit 73 të Kodit Doganor,

3.1.1. Kur zbatohet ndalimi i rimbursimit ose përjashtimi nga detyrimet e importit përmallrat joorigjinuese, që janë përdorur në prodhimin e produkteve, për të cilat është lëshuar një provë origjine në kuadër të një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve, territorave ose grup-vendeve ose territorave të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një borxh doganor importi lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore të rieksportit për këto mallra.

3.1.2. Kur lind një borxh doganor, sipas pikës 1, shuma e detyrimit të importit, që i korrespondon këtij borxhi, përcaktohet nën të njëjtat kushte si në rastin e një borxhi doganor që rrjedh nga pranimi në të njëjtën datë i deklaratës doganore për çlirim për qarkullim të lirë të mallrave joorigjinuese, të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë, me qëllim mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv.

3.1.3. Si rregull, debitor është personi i përcaktuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 72. Megjithatë, në rastin e mallrave joshqiptare të përcaktuara në nenin 242, debitor është personi, i cili depoziton deklaratën e rieksportit. Në rastin e përfaqësimit të tërthortë, debitor është gjithashtu edhe personi për llogari të të cilit bëhet deklarimi.

- 3.2. Në zbatim të pikës 6 të nenit 81 të Kodit Doganor, kur legjislacioni doganor parashikon një trajtim tarifor favorizues ose një përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit ose eksportit, sipas shkronjës “ç” deri “e”, të pikës 2, të nenit 56, të neneve 184, 185, 186, 187 dhe 189 ose 232 deri 235, ky trajtim tarifor favorizues ose ky përjashtim gjithashtu zbatohet në rastet kur borxhi doganor lind sipas neneve 74 ose 77, me kusht që faktet dhe rrethanat, që çuan në krijimin e borxhit doganor, të mos përbëjnë përpjekje për mashtrim

4. Debitorët solidarë

Në zbatim të nenit 79 të Kodit Doganor kur disa persona janë përgjegjës për pagesën e shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon një borxhi doganor, ata janë përgjegjës së bashku dhe veçmas për pagesën e shumës së plotë të borxhit.

Kështu, ne rastet kur ne vendimin e degës doganore përcaktohet se debitor është vetëm agjensia doganore apo edhe solidare, autoritetet doganore kërkojnë vjeljen e detyrimit nga kjo e fundit deri ne prekjen e garancisë se depozituar për ushtrimin e aktivitetit si përfaqësues i tërthortë. Ne këtë rast urdhërohet banka për prekjen e garancisë për vlerën e borxhit doganor dhe arkëtimin e kësaj vlere ne llogarie e DPD pranë degës se thesarit, shoqëruar me faturën për arkëtim.

5. Bazuar në përcaktimet e nenit 3 të ligjit Për Akcizat, të ndryshuar dhe VKM nr.612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për Akcizat”, të ndryshuar, përfaqësuesit fiskal, qoftë person fizik ose juridik, i kërcohët të paguajë çdo borxh akcize, të krijuar në përputhje me ligjin.

- 5.1. “Autoritete doganore kompetente” do të thotë autoritetet doganore që ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontolle në zonën ku është kryer dhe verifikuar shkelja e akcizës apo në zonën ku ajo është kompetente në një territor të caktuar.
- 5.2. Në këtë kuptim, përfaqësuesi fiskal mban përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet e tij në përputhje me prokurën që i jep të drejtën e përfaqësimit të drejtpërdrejtë për kryerjen e formaliteteve përkatëse.
- 5.3. Gjithashtu, çdo person përgjegjës për pagesën e akcizës, sipas përcaktimeve të nenit 9 të ligjit 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, apo çdo person tjetër që është i lidhur me shkeljen e konstatuar, është përgjegjës për shlyerjen e detyrimeve dhe penaliteteve personalisht dhe/ose bashkërisht.
- 5.4. Lindja e detyrimit të akcizës
 - 5.4.1. Për mallrat e akcizës detyrimi i akcizës lind në momentin e hedhjes së mallit për konsum në territor. Konsiderohen hedhje për konsum në territor:
 - a) dalja, përfshirë edhe daljen e parregullt, e produkteve të akcizës nga një regjim i pezullimit të detyrimeve;
 - b) mbajtja e produkteve të akcizës jashtë një regjimi pezullues të detyrimeve, ku akciza nuk është vjelë sipas këtij legjislacioni;
 - c) prodhimi, përfshirë edhe prodhimin e parregullt, i produkteve të akcizës, jashtë një regjimi të pezullimit të detyrimeve;
 - ç) importi, përfshirë edhe importin e parregullt, i produkteve të akcizës, me përjashtim të rastit kur produktet, menjëherë pas importit, janë futur nën një regjim të pezullimit të detyrimeve.
 - d) momenti i dërgimit të produkteve të akcizës nga një depozitives i miratuar drejt një personi juridik ose fizik, që nuk është i autorizuar të presë mallra akcize nën regjimin e pezullimit të detyrimeve;

- dh) momenti i prodhimit të produkteve të akcizës përtej sasive të parashikuara në nenet 66 e 73 të ligjit për akcizat;
- e) momenti i konsumimit të produkteve të akcizës për qëllime vetjake brenda ambienteve të magazinës fiskale;
- ë) momenti i krijimit të humbjeve apo firove të produkteve të akcizës, me përjashtim të humbjeve dhe firove të shfaqura gjatë periudhës së pezullimit të detyrimeve, nëse depozituesi i miratuar mund të provojë që këto humbje apo firo kanë ardhur si rezultat i një ngjarjeje të paparashikuar ose force madhore, ose që këto humbje a firo të lidhura në mënyrë të pandashme me karakteristikat e produktit janë shfaqur gjatë prodhimit, magazinimit dhe transportit të produkteve të akcizës;
- f) dita kur autorizimi i depozituesit të miratuar ose autorizimi i përjashtimit nga detyrimi i akcizës pushojnë së qeni të vlefshëm, sipas dispozitave të ligjit për Akcizat;
- g) momenti kur pritësi i regjistruar merr mallra akcize nën regjimin e pezullimit të detyrimeve, sipas nenit 30 të ligjit për akcizat.

5.4.2. Momenti i lindjes së detyrimit të akcizës në import :

- a) Në rastet e importit të mallrave të akcizës, detyrimi i akcizës lind në momentin e lindjes së borxhit doganor, sipas përcaktimeve përkatëse të Kodit Doganor, me përjashtim të rasteve kur detyrimi i akcizës pezullohet sipas dispozitave të këtij ligji.
- b) Në rast të iniciativave për ndryshime ligjore, që kanë për qëllim rritjen e nivelit të taksimit të akcizës, sasia e importit të mallrave të akcizës nga çasti i vendimit të Këshillit të Ministrave për propozimin për rritjen e saj deri në hyrjen në fuqi të ligjit për këtë nivel të akcizës, nuk mund të jetë më e lartë se 5 për qind më shumë se mesatarja mujore e vitit paraardhës, e importuar nga çdo operator i regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

5.4.3 Momenti i lindjes së detyrimit të akcizës për mallrat e konfiskuara, bashkimin e shoqërive tregtare, falimentin.

Detyrimi për pagesën e akcizës lind, gjithashtu, edhe kur:

- a) autoritetet doganore shesin ose japid për një qëllim të caktuar mallrat e akcizës, të konfiskuara, me përjashtim të rasteve kur ato i shiten ose i jepen depozituesve të miratuar ose përdoruesve të përjashtuar;
- b) produktet e akcizës hidhen në konsum gjatë bashkimit të shoqërive tregtare, me përjashtim të rasteve kur blerësi është, gjithashtu, depozitues i miratuar ose përdorues i përjashtuar;
- c) pas bashkimit të shoqërive tregtare, dërgohen produkte akcize te shoqëria tregtare e bashkuar, me përjashtim të rasteve kur shoqëria tregtare e bashkuar është depozitues i miratuar ose përdorues i përjashtuar, jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga plotësimi i aplikimit për regjistrimin e bashkimit në QKR;
- ç) produktet e akcizës janë hedhur për konsum ose dërguar te kreditori gjatë procedurave të falimentimit, me përjashtim të rasteve kur kreditori është depozitues i miratuar ose përdorues i përjashtuar.

5.4.4. Momenti i lindjes së detyrimit të akcizës për operacionet e parregullta Detyrimi për të paguar akcizën lind, gjithashtu, kur është vërtetuar se produktet e akcizës:

- a) janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur për konsum në mënyrë të parregullt, sipas përcaktiveve të këtij ligji;
- b) janë dërguar ose përdorur nga përdoruesi i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në autorizim.

III. DOSJA E DETYRIMEVE TE PAPAGUARA PAS KONSTATIMIT TE SHKELJES DOGANORE/AKCIZES.

1. Punonjësi i deleguar sipas rregullores së brendshme të Degëve Doganore (sipas specifikave te strukturës organike), pas konstatimit te shkeljes doganore/akcize, merr te gjitha masat për përgatitjen dhe plotësimin e dosjes se plote te detyrimeve te papaguara sipas shkeljes se konstatuar. (këtej e tutje për lehtësi do ta quajmë Dosja e Detyrimeve te Papaguara).
2. Kjo dosje duhet të përmbyaje:
 - a) Praktiken doganore/veprimet me mallra akcize, si dhe kopje te te gjithë dokumentacionit tregtar shoqërues, për të cilën është konstatuar shkelja.
 - b) Një raport/informacion të detajuar, ku të tregohet saktë procedura e ndjekur (kontrollet, verifikimet dhe konstatimet e kryera, nenet e shkelura) deri në përcaktimin e detyrimeve të papaguara, e cila i dërgohet degës doganore kompetente, nga struktura kontrolluese/konstatuese.
 - c) Prosesverbali i verifikimit të shkeljeve, sipas përcaktiveve në Manualin Udhëzues “Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës” dhe detyrimet e përllogaritura
3. Ne rastet kur shkelja administrative konstatohet, dhe rekomandimet jepen, nga struktura jo doganore (KLSH, Auditi i Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë, etj.), atëherë dega doganore përpara daljes me vendim duhet të mbajë një procesverbal në kuptim të Kodit Doganor dhe Ligjit të Akcizës.
 - 3.1 Ky procesverbal mbahet nga punonjësit e degës doganore të cilët vlerësojnë rekomandimet e lëna nga strukturat e mësipërme.
 - 3.2 Specialisti (C1) i Sektorit/Zyrës së Administratës dhe Shërbimit hap një dosje të veçantë, e cila do të përmbyaje dokumentacionin e përmendur në pikën 1, dhe raportin paraprak apo përfundimtar (sipas rastit, në varësi të procedurave respektive të secilit strukturë kontrolluese).

IV. MARRJA E VENDIMIT PER SHPALLJEN DEBITOR

Në zbatim të nenit 276 të Kodit Doganor:

1. Specialisti - Jurist/Specialist Borxhi, prane Sektorit/Zyrës së Administratës dhe Shërbimeve, dosjen e detyrimeve të papaguara të përgatitur me gjithë dokumentacionin sipas kërkesave te përcaktuara ne Pjesën III, te këtij udhëzimi, ja paraqet për shqyrtim dhe vendimmarrje Kryetarit te Degës se Doganës.
2. Në zbatim të nenit 276 të Kodit Doganor vendimi në rastet e flagrancës/urgjencës, merret brenda 24 orëve nga momenti i mbajtjes të procesverbalit të verifikimit të shkeljes dhe i njoftohet shkelësit brenda 24 orëve nga marrja e vendimit.

3. Në zbatim të nenit 276 të Kodit Doganor, në raste të tjera, vendimi i degës doganore kompetente merret:
 - a) kur procesverbali për verifikimin e shkeljes është mbajtur nga vetë dega doganore kompetente, maksimumi brenda 60 ditëve kalendarike nga data kur shkelësit i përfundon afati për paraqitjen e pretendimeve për procesverbalin, sipas përcaktiveve të pikës 4, të nenit 273 të Kodit Doganor, dhe i njoftohet me shkrim shkelësit, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit,
 - b) kur procesverbali për verifikimin e shkeljes (modeli sipas **Manualit Udhëzues Mbi Zbatimin e Dispozitave Lidhur me Shkeljet në Fushën Doganore dhe Akcizës**) është mbajtur nga strukturat e tjera kontrolluese, maksimumi brenda 60 ditëve kalendarike nga data kur dega doganore kompetente ka marrë dijeni për procesverbalin, sipas përcaktiveve të pikës 5, të nenit 273 të Kodit Doganor, dhe i njoftohet me shkrim shkelësit brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit.
4. Kur dega doganore kompetente vlerëson se nuk duhet marrë vendim për një procesverbal, u komunikon strukturave doganore, që kanë hartuar procesverbalin e verifikimit të shkeljes, arsyet e mosmarrjes së vendimit brenda afatit 60 ditor.
5. Në zbatim të nenit 95 të Kodit Doganor Llogaritja e detyrimeve qe duhet te paguhen nga debitori behet nga struktura që ka mbajtur proces-verbalin e verifikimit. Strukturat kompetente te degës doganore verifikojnë saktësinë e përllogaritjes ne procesverbal.
6. Procedura për marrjen e vendimit administrativ, për evidentimin e detyrimeve te papaguara nga debitori kryhet sipas përcaktiveve te mëposhtme:
 - a) Kryetari i Degës Doganore pasi shqyrton praktikën lidhur me shkeljen, ku përfshihen por pa u kufizuar, praktika doganore, procesverbali për verifikimit e kundërvajtjes administrative doganore/akcizës (sipas modelit të Manualit Udhëzues Mbi Zbatimin e Dispozitave Lidhur me Shkeljet në Fushën Doganore dhe Akcizës), procesverbal për verifikimin e kontrabandës, fletë inventari, etj, merr vendimin administrativ.
 - b) Kryetari i Degës së doganës për çështje të paqarta në procesverbal apo në praktikën lidhur me shkeljen mund të konsultohet edhe me specialistin/juristin apo specialistë (C1) pranë Sektorit të Zyrës së mbikëqyrjes doganore etj, me të cilët për çështje specifike mundet të ngrëjë edhe një grup pune për vlerësimin dhe daljen me një vendim të plotë dhe të mbështetur në ligj. Vendimi merret me shkrim nga Kryetari i Degës së Doganës kompetente mbështetur ne vlerësimin me shkrim të nxjerrë nga grupi i punës.

7. Vendimi administrativ

- 7.1. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë, ndër të tjera, detyrimisht kërkesat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative si më poshtë:
 - a) autoritetin që nxjerr vendimin;
 - b) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja;
 - c) identifikimin e deklaruesit/subjektit debitor të cilil i drejtohet akti (emri i shoqërisë)
 - ç) debitor/e, adresën, adresën elektronike dhe numrin NUIS/NIPT-it);
 - d) shpjegimin dhe argumentimin e fakteve që kanë të bëjnë me shkeljen;
 - dh) bazën ligjore ku përfshihen nenet e shkelura dhe nenet bazë te të cilat mbështeten sankzionet e parashikuara për çdo shkelje;

- e) shumën e detyrimit të pa paguar/shmangur dhe masën e penaliteteve;
 - ë) të drejtën për ankimin/apelim të shkelësit,
- 7.2. Dega doganore ne vendimet administrative te marra ndaj shkeljeve të përcaktuara në Kodin Doganor duhet të vendosë paragrafin si më poshtë:

"Kundër këtij vendimi mund te ushtroni ankim pranë Drejtorit te Përgjithshëm te Doganave. Ankimi duhet te depozitohet ne DPD brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Ankimi duhet te ketë bashkëlidhur mandat pagesën e 100% të detyrimit doganor dhe garancinë 100% të penalitetit".

- 7.3. Vendimi i shpalljes debitor behet pjese e dosjes se detyrimeve te papaguara. Vendimi i shpalljes debitor regjistrohet ne Database të Shkeljeve Doganore, sipas përcaktiveve ne Manualin Udhëzues të Shkeljeve doganore dhe të akcizës.

Ky vendim bëhet pjesë e deklaratës doganore duke iu bashkëlidhur dokumentave të tjera të praktikës doganore. Në versionin elektronik ngarkohet në AW duke plotësuar referencat përkatëse të dokumentit me kodin 905.

- 7.4. Vendimi përgatitet në 6 (gjashte) kopje dhe administrohet si vijon:

- një kopje për arshivën;
- një kopje për subjektin;
- dy kopje për dosjen e borxhit;
- një për t'u mbajtur ne dosje;
- një për t'u përdorur për procedurat e nxjerrjes se Urdhrit te Ekzekutimit ne gjykate.
- një kopje e vendimit i kalon menjëherë zyrës se financës për te kryer kontabilizimin e tij brenda afateve te parashikuara ne nenet 98-99 te Kodit Doganor dhe nenit 101 te Ligjit 61/2012 "Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë".
- një kopje për Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës ne DPD.

- 7.5. Ne ato dege doganore ku ne strukturën organike te saj ka te parashikuar specialist jurist dhe specialist borxhi, përgatitja e dosjes behet nga Juristi.

V. KONTABILIZIMI I DETYRIMEVE TE PAPAGUARA DHE RAPORTIMI

1. Mbështetur ne vendimin e shpalljes debitor, Kryetari i Degës Doganore, procedon si me poshtë:
 - a) Urdhëron kontabilizimin e detyrimeve te papaguara (borxh doganor/borxh akcize, penalite dhe kamate vonesat e përllogaritura nëse ka).
Ky kontabilizim behet nga financieri pranë Sektorit/Zyrës së Administratës dhe Shërbimit në Degën Doganore respektive ne përputhje me nenet 98-99 te Kodit Doganor, pikave dhe nenit 101 te Ligjit 61/2012 "Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë"
b) Regjistrimin ne data baze te shkeljeve ;
2. Kontabilizimi i shumes se detyrimeve behet ne zëra te veçante:
 - a) një zë për shumen e borxhit doganor (detyrimet e importit/eksportit te papaguara) dhe apo detyrimeve te akcizës.

- b) një zë për shumen e penaliteteve (penaliteteve).
 - c) një zë për shumen e kamate vonesave.
3. Llogaritja e detyrimeve te debitorit. Shuma e detyrimeve qe duhet te paguhen nga debitori përfshin:
- a) Borxhin Doganor te papaguar (shumen e detyrimeve te importit ose te eksportit) dhe apo Borxhin e akcizës te papaguar (nëse ka).
 - b) Penalitetin (nëse ka).
 - c) Kamate vonesat (nëse ka).
4. Përveç shumave te përcaktuara ne vendimin administrativ si me sipër, ne llogaritjen e detyrimeve te debitorit përfshihen edhe kamate vonesat.
- 4.1. Norma e kamatëvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit.
- 4.2. Llogaritja e kamatëvonesave bëhet sipas akteve ligjore në fuqi duke iu referuar edhe elementëve sa më poshtë vijon:
- a) Norma vjetore e kamatëvonesës
Në zbatim të nenit 107 të Kodit Doganor, norma e kamatëvonesës është e njëjtë me normën e aplikuar në ditën e parë të muajit në fjalë nga Banka e Shqipërisë, për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, të rritura me 2%.
 - b) Afati (dita) kur fillon zbatimi i kamatëvonesës
 - i. Zbatimi i kamatëvonesës mbi detyrimet e papaguara duhet të fillojë nga momenti i njoftimit të debitorit për ekzekutim të vendimit të shpalljes debitor të përmendur në Pjesën VI, te udhëzimit.
 - ii. Kur një borxh doganor lind sipas nenit 74 ose 77 të Kodit Doganor apo kur njoftimi i borxhit doganor vjen në vijim të një kontrolli, pas çlirimt, norma e kamatëvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit, duke filluar nga data, në të cilën lind borxhi doganor deri në datën e njoftimit të tij.
 - iii. Norma e kamatëvonesave vendoset në përputhje me shkronjën a).
 - iv. Për rastet e lindjes se borxhit te akcizës për operacionet e parregullta momenti i zbatimit te kamatëvonesës do te jete momenti ne te cilin konstatahet lindja e detyrimit te akcizës qe i korrespondon momentit kur është vërtetuar se produktet e akcizës janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur për konsum në mënyrë të parregullt si dhe janë dërguar ose përdorur nga përdoruesi i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në autorizim.

5. Raportimi ne DPD

Specialisti – Jurist/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit, ne degën doganore, raporton ne DPD (Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave) çdo muaj mbi gjendjen e detyrimeve te papaguara.

VI. NJOFTIMI I VENDIMIT

1. Njoftim Vendimi, është akti, me anën e te cilit Autoriteti Doganor (AD) i bën me dije shkelësit për shpalljen debitor nga ky autoritet. Ne këtë njoftim, është përcaktuar, ndër te tjera, borxhi doganor/akcizës (nëse ka), shuma e penalitetit (nëse ka) qe duhet te paguhet nga ky debitor ndaj administratës doganore. Ne këtë njoftim është përcaktuar edhe afati 10 ditor për detyrimet e papaguara doganore ose 30 ditor për detyrimet e papaguara te akcizës për kryerjen e pagesës se detyrimeve te papaguara ne mënyrë vullnetare. Njoftim vendimi ka te bashkëlidhur kopjen e vendimit për shpalljen debitor.
2. Autoriteti / struktura qe kryen procedurën e Njoftimit te Vendimit .
 - 2.1. Në zbatim të nenit 276 të Kodit Doganor, nenit 99 te ligjit nr. 61/2012 "Per Akcizat në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Procedurës Administrative, Dega e Doganës përgjigjet drejtpërdrejtë për kryerjen e njoftimit të Vendimit. Këtë procedurë Dega Doganore e kryen nëpërmjet Specialistit – Jurist/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit së Administratës dhe Shërbimit.
 - 2.2 Procedura e njoftimit të subjektit debitor te Vendimit, si rregull behet sipas neneve 130-141/a te Kodit Procedurës Civile dhe procedurave te mëposhtme:

Specialisti – Juristi/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit së Administratës dhe Shërbimit bën njoftimin sipas procedurave te mëposhtme:

- a) Të gjithe njoftimet e Vendimeve Administrative dërgohen pranë adresës zyrtare të subjektit (Sipas QKB-së) me poste me letër rekomande, brenda 10 ditëve nga marrje e Vendimit Administrativ. Njoftimi quhet i kryer vetëm atëherë kur ka mbërritur konfirmimi i postes për dorëzimin e letrës rekomande, konfirmim ky qe futet ne dosjen e detyrimeve te papaguara/ debitorit. Njoftimi bëhet edhe në formë elektronike në adresën e-mailit të debitorit ose përfaqësuesit ligjor të tij (agjensia doganore), të deklaruara në formularin e registrimit, por në cdo rast kërkohet njoftimi zyrtar me postë rekomande..
 - b) Njoftim Vendimi hartohet ne tre kopje, te cilat pasi është firmosur ose pas ardhjes te letrës rekomande, administrohen si me poshtë :
 - një kopje e kunderfirmosur/zarfin me Njoftim Vendimi e mban debitori.
 - dy kopjet e tjera te kunderfirmosura/ose kopje te letrës rekomande i mban përfaqësuesi i administratës doganore, nga te cilat:
 - një kopje i bashkëlidhet dosjes se debitorit.
 - një kopje (e treta) do te shërbejë për t'u dërguar ne gjykate për nxjerjen e Urdhrit te Ekzekutimit.
3. Ne rastet e mos marrjes se konfirmimit per njoftim procedohet me format e tjera te njoftimit si më poshtë:
 - a) Kur njoftimi sipas procedurave te mësipërme (nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e debitorit, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar) bazuar ne nenin 141 germa (a) te Kodit Civil, ky njoftim behet nëpërmjet afishimit pranë adresës se regjistruar ne Qendrën Kombëtare te Biznesit;

- b) Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund te behet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do te vihen ne stendën e krijuar posaçërisht për njoftim pranë çdo Dege Doganore (ne vendin ne te cilin trajtohet çështja) si dhe ne vende publike, si ne Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, ne internet dhe me mjete te tjera audiovizive etj.

Ne këto raste pas kalimit te një periudhe 30 ditore subjekti debitor konsiderohet i njoftuar;

4. Një kopje e Njoftim Vendimit së bashku me vendimin për shpalljen debitor i vihet në dispozicion menjëherë Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjenda në llogarinë parapaguese mbulon detyrimin doganor.

5. Afati i njoftimit

- 5.1. Ne rastet kur shkelja e konstatuar trajtohet sipas Kodit Doganor, njoftimi behet brenda 24 orëve nga data e marrjes se vendimit, në rastet e flagrancës/urgjencës dhe ne rastet e tjera brenda 10 ditëve kalendarike, përmes Njoftim Vendimi (Formati tip i Njoftim Vendimit jepet bashkëlidhur).
- 5.2. Ne rastet kur shkelja e konstatuar trajtohet sipas Ligjit Nr 61/2012 "Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, njoftimi behet brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit përmes Njoftim Vendimi.

6. Nëse:

- a) subjekti debitor ka gjendje kreditore ne llogarinë parapaguese, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim-i/et për shpalljen debitor, specialisti (C 1) pranë Sektorit të Zyrës së mbikëqyrjes doganore apo Përgjegjësi i Zyrës se Mbikëqyrjes Doganore (Cl):
 - prek llogarinë, duke amenduar deklarat-ën/at respektive.
 - njofton me e-mail Subjektin debitor apo Agjentin e tij dhe Specialistin – Juristi/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit së Administratës dhe Shërbimit në degën doganore për veprimin e kryer.
 - b) gjenda e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së mbikëqyrjes doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (Cl), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar shumën përkatëse në ilogarinë parapaguese.
7. Dega Doganore njofton menjëherë Vendimin dhe Njoftimin e kryer për debitorin pranë strukturave përkatëse të DPD-së që menaxhojnë garancitë e vendosura për qëllime të përfitimit të rregjimeve doganore ose autorizimeve të akcizës, duke kërkuar prekjen e menjëershme të saj sipas kushteve të autorizimit/ rregjimit. Në rastet kur malli nën regjimin doganor/ pezullues i akcizës është i çliruar për konsum apo nuk gjendet (por është garantuar me garanci) atëherë preket garancia e depozituar për mbulimin e risqeve te mundshme te detyrimeve. Në rastin kur kjo garanci nuk është e mjaftueshme, zbatohen paralelisht edhe masat e tjera te parashikuara ne dispozitat ligjore ne fuqi dhe pikat e mëposhtme.

Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore pranë D.P.D, do të sigurojë garantimin e pagesës së detyrimeve të pashlyera nëpërmjet kërkesës për prekje të shumës së garancisë të debitorit (deklaruesit) në një nga bankat e nivelit të dytë apo shoqërive të sigurimit, garantuesve, dorëzanësve, etj.

Kërkesa për prekje të garancisë për pagesë detyrimesh të pashlyera në mënyrë vullnetare duhet të shkojë zyrtarisht pranë bankave, shoqërise të sigurimit apo garantuesve, dorëzanësve, etj. Për çdo kërkesë të DPD-së garantuesi detyrohet të debitojë llogarinë e garancisë të deklaruesit, të depozitar për llogari të DPD-së duke kredituar njëkohësisht llogarinë e DPD-së (Llogaria Qendrore e të Ardhurave). Ky veprim duhet të shoqërohet detyrimisht me kalimin e shumës përkatëse, në mënyrë automatike/ elektronike, në llogarinë parapaguese në sistem. Me marrjen e njoftimit për kalimin e shumës në llogari dhe në sistem, Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore do të ndërhyje në llogarinë e garancisë të deklaruesit në sistem nëpërmjet tërheqjes nga sistemi të shumës korresponduese dhe të vijojë më tej me procedurat për njoftimin e deklaruesit.

VII. EKZEKUTIMI I VENDIMIT I SHPALLJES DEBITOR

1. Shlyerja vullnetare

- 1.1. Debitori me marrjen dijeni për vendimin e shpalljes debitor, për pagimin e detyrimeve te papaguara mund te shlyeje vullnetarisht brenda afatit te përcaktuar detyrimet e papaguara. Shlyerja vullnetare e detyrimeve te papaguara behet nga debitori nëpërmjet pagesës te borxhit doganor/akcizës, për llogari te DPD - së (Llogaria Qendrore e te Ardhurave), nëpërmjet kreditimit te llogarisë parapaguese te Sistemit Informatik ndësa pagesa e penaliteteve (nëse ka) dhe kamate vonesave (nëse ka) ne llogarinë e Degës Doganore pranë Degës se Thesarit ne rrëthim përkatës, konform faturës për arkëtim te lëshuar nga zyra e financës ne degën doganore.
- 1.2. Pas arkëtimeve te detyrimeve te papaguara nga debitori (borxh doganor, penalitet etj), nga Specialisti – Juristi/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit së Administratës dhe Shërbimit në degën doganore, iu vihet ne dispozicion kopje e vendimit administrativ dhe e mandat pagesës, Drejtorisë së Vlerësimit në Qendër pranë DPD, për rastet kur kjo strukturë është struktura konstatuese ose Specialistit pranë Sektorit të Mbikëqyrjes në Degë, nga të cilët respektivisht bëhet menjëherë amendimi i deklaratës doganore.

Pas amendimit te deklaratës doganore, dega doganore procedon me njoftimin e Degës Rajonale te Tatimeve për deklaratat e amendoara.

- 1.3. Specialisti apo Përgjegjësi i Sektorit të Mbikëqyrjes në Degën Doganore, monitoron/ mbikëqyr hartimin e DSHA nga debitori.
- 1.4. Pas ndërhyrjes ne Deklaratë/DSHA kopjet e tyre i dërgohen Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit për shuarjen e borxhit dhe regjistrimin ne kontabilitet. Dokumentacioni i pagesave, Deklarata e amendoar, DSHA e hartuar, bëhen pjese e dosjes se detyrimeve te papaguara.

1.5. Ne rastet kur debitor është një person (person fizik/juridik) i pa regjistruar ne sistemin informatik te doganës, ai duhet te paraqitet pranë DPD-se për te regjistruar NIPT-in ne Drejtoreni e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave apo ID (numrin personal te identifikimit) ne Drejtoreni e Buxhetit dhe Financës. Pas regjistrimit për te dy rastet e sipërcituara hapet llogaria parapaguese pranë Drejtorisë se Buxhetit dhe Financës.

1.5.1. Për debitorët e përmendur në këtë pikë, zyra/Sektori i Administratës dhe Shërbimit të degës doganore qe merr vendimin udhëzon subjektin qe:

- arkëtimi i detyrimeve te papaguara te behet për llogari te Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, llogaria qendrore e te ardhurave doganore;
- arkëtimi i penaliteteve te behet ne llogarinë e degës se doganës pranë degës se thesarit ne rrëthim përkatës, konform faturës për arkëtim te lëshuar nga kjo zyre.

1.5.2 Pasi debitori paguan detyrimet ne bankën e nivelist te dyte, ne sistemin e doganës është kredituar llogaria parapaguese e tij, tashme e celur.

1.5.3 Ne mungese te hartimit të nje praktike doganore DAV apo DSHA, në këto raste, dega doganore i kërkon zyrtarisht Drejtorese së Buxhetit dhe Financës sistemimin e situatës duke dhënë shpjegime të hollësishme mbi pamundësinë e amendimit apo hartimit të deklaratës doganore apo hartimit të DSHA. Kjo e fundit pasi bën debitimin manual të llogarisë parapaguese të debitorit, bën njoftimin e deges për mbylljen e detyrimit. ne sistemin informatik te doganës duke bere debitimin manual te llogarise parapaguese ne sistem, per rastin konkret, ne perputhje me dokumentacionin e derguar nga dega.

2. Ekzekutimi me force /Vendimi për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me force te detyrimeve te papaguara doganore

2.1. Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja qe debitori ka marre dijeni mbi njoftim vendimi/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit te afatit 10 ditore për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar ne nenet 280 te Kodit Doganor dhe nenin 103 te ligjit 61/2012 “Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë”, ne zbatim te nenit 133/3 te Ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” kalon ne ekzekutimin forcërisht përmes nxjerjes se vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me force te detyrimeve te papaguara doganore/akcizës. Ky vendim behet pjese e dosjes se detyrimeve te papaguara.

2.2. Vendimi per zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me force te borxhit doganor (sekuestro konservative) përcakton ndër te tjera:

- sekuestrimin e vlerave monetare, të kreive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve, me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit ose garantuesit/ve;

- b) sekuestrimin e mallrave, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkasin debitorit ose garantuesit/ve, i cili/të cilët ka/kanë detyrime kundrejt debitorit.
- 2.3. Pas nxjerrjes se vendimit te Degës Doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me force te detyrimeve te papaguara doganore/akcizës (sekuestros konservative), Dega Doganore merr masat për njoftimin e këtij vendimi subjektit debitor. Procedura e njoftimit zbatohet në përputhje me Pjesën VI, te këtij udhëzimi.
- 2.4. Ne momentin e njoftimit te debitorit te vendimit per zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me force te borxhit doganor/borxhin e akcizës si dhe te gjithë detyrimeve te papaguara (sekuestros konservative), ky i fundit kthehet ne Titull ekzekutiv.
- 2.5. Ne rastet kur ne Vendim e shpalljes debitor përcaktohet se debitor është Agjencia Doganore vetëm apo edhe me persona te tjerë, autoritetet doganore kërkojnë vjeljen e detyrimit te papaguar përmes prekjes se garancisë se depozituar për ushtrimin e aktivitetit si përfaqësues i tërthortë. Ne këtë rast dega doganore i kërkon Drejtorise se Buxhetit dhe Finances të kërkoje nga banka prekjen e garancisë dhe arkëtimin e kësaj vlere ne llogarinë e DPD pranë degës se thesarit, shoqëruar me faturën për arkëtim.
- 2.6. Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import, qoftë në export.

3. Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit për shpalljen debitor, rikuperimi i detyrimeve te papaguara te lindura ne momentin e zhdoganimit te mallit

- 3.1. Ne zbatim te neneve 179, 280 të Kodit Doganor dhe të Kodit të Procedurës Administrative, ne rastet:
- a) e lindjes se detyrimeve te papaguara doganore gjate kryerjes se procedurës se zhdoganimit, edhe pse subjekti është ankuar, kjo e fundit nuk e çliron mallin pa u plotësuar te gjitha kushtet e mëposhtme njëherësh:
- Te paguhet shuma e plete e borxhit doganor, shume e cila duhet te pasqyrohet ne deklaratën doganore.
 - Te garantohet 100% e gjobës sipas vendimit te degës doganore.
 - Vetëm pasi janë kryer pagesat e sipërcituara Dega Doganore procedon me çlirim e mallit me lëshimin e Urdhër Çlirimit.
- b) kur debitori rezulton se ka detyrime te tjera te papaguara te prapambetura (te pashlyera) me vendim tjetër administrativ, dega doganore pas kryerjes se pagesave ne lidhje me shkeljen sipas pikës 1, te Pjesës VII, procedon me rikuperimin me force te detyrimeve te papaguara te prapambetura dhe malli nuk çlirohet pa u bere pagesat përkatëse.

VIII. NXJERRJA E URDHrit TE EKZEKUTIMIT

1. Menjëherë mbas marrjes dijeni te vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me force te detyrimeve te papaguara, pra paas kthimit ne titull ekzekutiv, specialisti – Jurist/Specialist Borxhi i Sektorit/Zyrës së Administratës dhe Shërbimit në degën doganore, dërgon ne gjykate kërkeshën për nxjerrjen e urdhrit te ekzekutimit.
2. Kërkesa drejtuar gjykatës shoqërohet nga:
 - a) Vendimi i Degës Doganore për detyrimet e papaguara
 - b) Vendimi i Degës Doganore për marrjen e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me force te borxhit doganor/borxhit te akcizës, penaliteteve dhe kamat vonesave (ne se ka) (sekuestros konservative);
 - c) Njoftimin e debitorit sipas kërkeshave te Pjesës VI, te këtij udhëzimi dhe Njoftimin e vendimit administrativ per zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me force te detyrimeve te papaguara; dhe ne se është e nevojshme;
 - ç) Procesverbalet, konstatimet ose raportet e kontrollit;
 - d) Kopje te praktikes doganore.
3. Ne Kërkeshën për nxjerrjen e Urdhrit te Ekzekutimit duhet te jene te formuluara qarte elementet kryesore, (te cilët duhet t'i përmbajë edhe Urdhri i Ekzekutimit i lëshuar nga gjykata) si me poshtë:
 - a) Njohjen dhe detyrimin e subjektit debitor për te paguar detyrimet e papaguara sipas specifikimeve te Vendimeve te Degës Doganore dhe për te zbatuar masat për rikuperimin forcërisht te detyrimeve te papaguara;
 - b) Përcaktimin e Degës se Doganës qe ka marre Vendimin për deklarimin debitor te subjektit, dhe Zyrën e Përmbarimit qe ka juridiksonin për ekzekutimin e Urdhrit te Ekzekutimit.
4. Dega Doganore është përgjegjëse për dërgimin sipas ligjit te akteve te mësipërme ne Gjykate dhe nxjerrjen e Urdhrit te Ekzekutimit .
5. Ne te gjitha rastet, kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit te Ekzekutimit, Urdhri i Ekzekutimit i nxjerre nga gjykata, si dhe çdo akt tjeter i gjykatës, bëhen pjese e dosjes se debitorit.

IX. EKZEKUTIMI I URDHrit TE EKZEKUTIMIT

Në zbatim të nenit 280 të Kodit Doganor dhe nenit 103 te ligjit 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ekzekutimi i Titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve te papaguara (sekuestros konservative), mund të bëhet:

1. përmes Zyrave Përmbarimore;
2. nga vetë autoritetet doganore, përmes strukturave të rikuperimit me forcë dhe Degëve Doganore, në bazë të dispozitave të ligjore në fuqi.

1. Ekzekutimi i Urdhrit te Ekzekutimit nga Zyra Përmbarimore

- 1.1. Ne zbatim te nenit 280 te Kodit Doganor dhe nenit 103 te ligjt 61/2012 "Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë", Dega Doganore kompetente qe ka evidentuar borxhin doganor/borxhin e akcizës, menjëherë me nxjerrjen e Urdhrit te Ekzekutimit sipas Pjesës VIII, te këtij udhëzimi dërgon pranë Shërbimit Përmbarimor kërkeshen për ekzekutimin e këtij Urdhri te Ekzekutimit për rikuperimin me force te borxhit doganor/borxhit te akcizës.
- 1.2. Kërkesa për Zyrën Përmbarimore shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:
 - a) Kopje e njehsuar me origjinalin e vendimit te Gjykatës "Për nxjerrjen e Urdhrit te Ekzekutimit";
 - b) Kopje e njehsuar me origjinalin e Vendimit te Degës se Doganës kompetente për detyrimet e papaguara ;
 - c) Kopje e njehsuar me origjinalin e Vendimit te Degës se Doganës kompetente për rikuperimin forcërisht te Borxhit doganor/borxhit te akcizës dhe detyrimeve te tjera te papaguara (sekuestros konservative);
 - ç) Te dhëna te plota ne lidhje me debitorin si: emrin e debitorit, përfaqësuesin ligjor i tij, adresën si dhe ne rast se është e mundur edhe te dhëna mbi numrin e llogarisë bankare dhe te pasurive te patundshme.
- 1.3 Ne zbatim të Urdhrit Nr. 4321/4, datë 18.7.2017 "Për miratimin e modelit te kontratës që lidhet midis shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit", Dega Doganore t'i kërkojë informacion me shkrim Zyrës Përmbarimore, lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për të gjitha veprimet e kryera, informacion të cilin më pas ia përcjell Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, pranë DPD.

2. Ekzekutimi i Urdhrit te Ekzekutimit nga vete Autoriteti Doganor

2.1. Lajmërimi për ekzekutim vullnetar

- 2.1.1. Dega Doganore, kur fillon vete ekzekutimin e Urdhrit te Ekzekutimit, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 10 ditësh.
- 2.1.2. Lajmërimi duhet të përmbajë:
 - a) një shkurtim të përmbajtjes së urdhrit të ekzekutimit,
 - b) vendin dhe adresën e Degës Doganore,
 - c) numrin e llogarisë, dhe
 - ç) paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm, në qoftë se ekzekutimi nuk kryhet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim.
- 2.1.3. Formati tip i lajmërimit paraqitet ne aneksin e këtij udhëzimi dhe është pjese e tij. Në formularin e njoftej, mund të parashikohet detyrimi i debitorit për të deklaruar, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen.
- 2.1.4. Subjekti debitor, me marrjen dijeni për lajmërimin për ekzekutim vullnetar të Urdhrit te ekzekutimit ka te drejte dhe mund te beje shlyerjen vullnetarisht te detyrimeve te papaguara.

2.1.5. Shlyerja vullnetare e detyrimeve te papaguara kryhet ne përputhje me pikën 1, të Pjesës VIII, të këtij udhëzimi.

2.2. Ekzekutimi i detyrueshëm i urdhrit të ekzekutimit nga autoritetet doganore.

2.2.1. Bashkëpunimi me strukturat e DPD-se per ekzekutimin e Urdhrit te Ekzekutimit

- a) Menjëherë pas kalimit të afatit për ekzekutimin vullnetar të Urdhrit të Ekzekutimit, me qëllim mundësimin e ekzekutimit të detyrimeve të papaguara, Dega Doganore ne zbatim te neneve 280, 282 te Kodit Doganor, Nenit 103 te Ligjt 61/2012 dhe ne mbështetje te 172 te Kodit te Pr. Administrative fillon ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Për këtë qellim Dega Doganore, kërkon nga DPD (Drejtoria e Financë, Drejtoria e Antikontrabandës, Departamenti Teknik dhe i Akcizës), kryerjen e procedurave, si vijon:
 - i. Pezullimin e autorizimit të Regjimit doganor (përpunim aktiv, pasiv, magazinim doganor, regjim i lejimit të përkohshëm, etj...)
 - ii. Pezullimin e autorizimeve të akcizës (depozitues i miratuar, pritës i regjistruar dhe magazinës fiskale) e shoqëruar me plumbosjen e ambienteve te operatorit.
 - iii. Prekjen e garancive të vendosura për qëllim të përfitimit të regjimit doganor apo autorizimeve të akcizës (nëse ka) Në rastet kur malli nën regjimin doganor/ pezullues i akcizës është i çliruar për konsum apo nuk gjendet (por është garantuar me garanci) atëherë preket garancia e depozituar për mbulimin e risqeve te mundshme te detyrimeve. Në rastin kur kjo garanci nuk është e mjaftueshme, zbatohen paralelisht edhe masat e tjera te parashikuara ne dispozitat ligjore ne fuqi dhe pikës 2.3.
 - iv. Bllokimin në sistem të subjektit debitor.

2.2.2. Bashkëpunimi me Institucionet e tjera për ekzekutimin e Urdhrit te Ekzekutimit

Dega Doganore me qellim ekzekutimin e Urdhrit te Ekzekutimit i drejtohet :

- a) Drejtorisë së Përgjithshme te Tatimeve me kërkesën për:
 - i. informacion për aktivitetin tregtar (magazinat, mallrat etj) të debitorit dhe
 - ii. bllokimin e aktivitetit të tij tregtar.
- b) Qendrës Kombëtare te Biznesit (QKB) me kërkesën për:
 - i. informacion për të dhënat tregtare që disponon për shoqërinë debitore dhe
 - ii. bllokimin e çdo veprimi tregtar që ka lidhje me debitorin, pranë QKR.
- c) Bankave për: informacion për llogaritë bankare dhe llogaritë depozitë të debitorit dhe bllokimin e sekuestrimin e menjëhershëm të vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit, personave të tretë ose garantuesve që kanë detyrime kundrejt debitorit në shumën që i korrespondon detyrimeve të papaguara, deri në

- momentin që shuma përkatëse të janë shlyer dhe të informohen nga Bankat për këto veprime.
- c) Të gjitha Zyrave të Republikës se Shqipërisë, siç janë zyrat e regjistrimit të mjeteve motorike, mjeteve lundruese, të regjistrimit të aksioneve, të regjistrimit te tituve shtetërore metaleve dhe gurëve te çmuar, të cilat janë të ngarkuara nga ligji për të bërë regjistrimin e pasurive të luajtshme me kërkasen per informacion nëse në emër të debitorit, figurojnë të regjistroara në pronësi të tij sende, të cilat ato janë të detyruara t'i regjistrojnë, si dhe vendosjen ndaj tyre të sekuestros.
- d) Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme qe:
- i. të bëjnë identifikimin e pasurive të paluajtshme të debitorit dhe
 - ii. të bëjnë vendosjen në hipotekë të tyre në favor të administratës doganore, në masën që i përkasin shumës së detyrimeve të papaguara, deri në momentin që shuma përkatëse të janë shlyer dhe të informohen nga ZRPP për këto veprime.

2.3. Vendasja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor:

- 2.3.1. Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sekuestros Ekzekutive mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimeve te papaguara.
- 2.3.2. Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore qe ka nxjerre vendimin për rikuperimin forcërisht detyrimeve te papaguara;
- 2.3.3. Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive përmban elementet e mëposhtëm:
- a) shuma e papaguar;
 - b) afati për pagesën e shumës;
 - c) pasuria që sekuestrohet;
 - d) mënyra e ekzekutimit të sekuestrit;
- 2.3.4. Formati Tip i Urdhrit për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive paraqitet ne aneksin e këtij udhëzimi dhe është pjese e tij.
- 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontrabandës.
- 2.3.6. Pas evidentimit të pasurive, me qëllim përshkrimin e saktë të veprimeve që kryhen me pasurinë dhe për përshkrimin e hollësishëm të pasurisë, Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontrabandës kryejnë realisht sekuestron ekzekutive mbi pasuritë e debitorit. Për këtë qellim këto struktura pas evidentimit ne vend te pasurisë qe do te sekuestrohet mbajnë procesverbalin e sekuestros në vendin ku ndodhet pasuria e debitorit.
- 2.3.7. Procesverbal i sekuestros përmban informacionin, si vijon:
- a. datën dhe vendin e kryerjes së veprimit;
 - b. të dhënat e punonjësve doganorë, funksionet e tyre si dhe të dhënët e debitorit dhe personave te tjerë të pranishëm;
 - c. të dhëna për vendimin për kalimin menjëherë në ekzekutim të detyrueshëm
 - d. të dhëna për urdhrin e ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata;
 - e. urdhrin e sekuestros ekzekutive;

- f. kërkesat dhe deklarimet e bëra nga palët;
- g. përshkrim i hollësishëm i sendeve që sekuestrohen dhe çdo informacion i vlefshëm me qëllim identifikimin sa më të mirë të tyre si dhe vlerësimin e tyre;
- h. ku dërgohen / ku ruhen sendet e sekuestruara;
- i. nënshkrimin e personave që marrin pjesë;
- j. shënimë të tjera të vlefshme

2.3.8. Formati i Procesverbalit tip paraqitet bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjese e tij.

2.3.9. Sekuestrimi i pasurisë bëhet në prani të debitorit ose të familjarëve të tij (persona madhorë të familjes), të administratorit të lagjes apo të kryeplakut të fshatit apo një përfaqësuesi të qeverisjes vendore dhe, në mungesë të tyre, në prani të dy dëshmitarëve. Në rastet kur debitori kundërshton nënshkrimin e procesverbalit, ky fakt evidentohet në atë procesverbal.

2.3.10. Pasuritë, sendet, të hollat e evidentuara që i përkasin debitorit, për të cilat mbahet procesverbali i sekuestros konfiskohen në favor te shtetit.

- a. Konfiskimi bëhet përmes nxjerjes së Vendimit të Konfiskimit nga Dega Doganore që ka nxjerrë urdhrin e sekuestros ekzekutive.
- b. Sendet e konfiskuara në zbatim të Kodit Doganor dhe ligjt për Akcizat, shiten në ankand, me përjashtim të rasteve kur në këto akte parashikohet shkatërrimi i tyre.

2.3.11. Dega Doganore gjate procedurës se sekuestrit mund te kërkojë mbështetje nga:

- a) **Departamenti Operativ Hetimor** mbështet drejtpërdrejt Degën e Doganës për sekuestrimin e mallit, ruajtjen dhe transportimin e dorëzimin e tij ne vendet e caktuara për magazinimin e tyre nga administrata doganore.
- b) **Departamenti Administrativ** ne varësi nga malli i sekuestruar dhe me kërkesë te Degës se Doganës mbështet drejtpërdrejt për sigurimin ne kohe te burimit finansiar dhe kontraktimin me shoqërinë e transportit për sigurimin ne kohe te mjeteve për ngarkim, shkarkim dhe transportim te mallit te sekuestruar apo konfiskuar.
- c) **Departamenti Teknik dhe i Akcizës** mbështet Degën e Doganës për sigurimin ne kohe te kontrollit cilësor te mallit nga autoriteti kompetent dhe nese është e nevojshme edhe nëpërmjet Laboratorit Doganor. Jep konsulencë për kontrollin cilësor, sekuestrimin e mallit dhe vlerësimin e tij, si dhe ne sekuestrimin e vlerave monetare e te sendeve te paluajtshme dhe për probleme te tjera që dalin gjate procedimit për rikuperimin forcërisht te detyrimeve.
- ç) **Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit** mbështet Degën Doganore gjatë sekuestrimeve të produkteve në ambientet e magazinave, sekuestrit të makinerive, impianteve apo rafinerive të përdorura për prodhimin e produkteve.

X. ANKIMI ADMINISTRATIV

1. Bazuar ne:

- Ligjin 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës se Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligjin nr.61/2012 “Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kundër vendimit te Degës Doganore përkatëse për pagimin e detyrimeve doganore/akcize te papaguara, debitori mund te ankohet tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave duke plotësuar respektivisht kushtet e përcaktuara ne nenit 282 te Kodit Doganor” i ndryshuar, ne rast se ndodhemi përparrë një

- shkelje në fushën doganore dhe kushtet e përcaktuara në nenin 105 te ligjit 61/2012 “Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ne rast se ndodhemi përparrë një shkelje në fushën e akcizës si dhe
- Nenit 736 të VKM nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese te Ligjt nr.102/2014 “Kodi Doganor i RSH”

2. Ankimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore në lidhje me një borxh dhe/ose me një sanksion sipas përcaktiveve të nenit 282 të Kodit Doganor (102/2014) .

2.1. Subjekti debitor mund te ankohet kundër vendimit të autoritetit doganor për një shkelje në fushën doganore (të marrë në bazë të dispozitave të Kodit Doganor) duke plotësuar kushtet e detyrueshme ligjore të parashikuara në nenin 282 te Kodit Doganor.

Konkretnisht:

- a) kërkesa ankimore,e arsyetuar, duhet te ushtrohet brenda 30 ditëve nga momenti njoftimit të vendimit (marrjes dijeni);
- b) duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, sipas vendimit përkatës të Degës doganore;
- c) te garantoje për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti.

Garantimi i penalitetit duhet të kryhet vetëm nga Bankat e Nivelit të Dytë dhe formati i kësaj Garancie Bankare duhet të jetë në përputhje me formatin e Aneksit 80, Shtojca B te VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjt nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

2.2. Me paraqitjen e kërkesës ankimore, Drejtoria Juridike në DPD :

- a) Bazuar në konfirmimin e Degës Doganore (me shkresë dhe/ose e-mail), për datën ne te cilin debitori ka marre dijeni për vendimin/njoftim vendimin e shpalljes debitor, verifikon nëse është respektuar afati 30 ditor për depozitimin e ankimit, i parashikuar ne nenin 282 te Kodit Doganor.
- b) Ne rast se apeluesi është ne tejkalim te afatit sipërcituar, Drejtoria Juridike procedon me mosshqyrtimin e ankimimit, ne zbatim te pikës 8 te nenit 282 te ligjt 102/2014, duke e konsideruar të paezauruar rrugën administrative si rrjedhoje e mosplotësimit të kushteve ligjore që ka parashikuar ky nen. Ankimi konsiderohet se nuk është kryer.
- c) Nëse rezulton se ankimi administrativ është ushtruar brenda afatit ligjor të parashikuar, Drejtoria Juridike referuar dokumentacionit te vene ne dispozicion nga shoqëria bashkëlidhur kërkesës ankimore verifikon nëse janë vendosur pagesa e 100% detyrimi doganor dhe garantimi 100% të gjobës/ ose pagesë e plotë që kerkohen nga neni 282 te Kodit Doganor.
- ç) Çdo vendim marrje e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave i njoftohet apeluesit, Degës Doganore që ka marre vendimin administrativ për shpalljen debitor, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, si dhe strukturave të tjera përfshirëse /konstatuese të shkeljes doganore.

- d) Pavarësisht draftit paraprak, Vendimi përfundimtar është në diskrecion të Drejtorit te Përgjithshëm dhe duhet te përbaje edhe te drejtën dhe afatin për ankim pranë autoriteteve gjyqësore.
- 2.3. Ne zbatim te pikës 5 te nenit 282 te Kodit Doganor, ne rast se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vendos rrëzimin e kërkesës ankimore (lihet ne fuqi vendimi i degës doganore) Drejtoria Juridike i përcjell origjinalin e garancisë të depozituar Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit e cila bën kalimin e menjëhershëm te shumes se garancisë ne llogarinë e DPD.
- 2.4. Ne rast se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vendos pranimin e ankimit/rekursit administrativ procedohet me shfuqizimin e vendimit te degës doganore dhe me rregullimin e pasojave financiare. Drejtoria e Financës procedon me çlirimin e garancisë dhe/ose kthimin e shumes se paguar ne zbatim e vendimit administrativ te shpalljes debitor.
- 2.5. Nëse Drejtori i Përgjithshëm vendos dërgimin e vendimit objekt ankimimi administrativ për rishikim pranë degës doganore përkatëse, pas rishikimit dega doganore njofton ne DPD, strukturën konstatues të shkeljes dhe Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës duke dërguar një kopje te vendimit te rishikuar. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës bën rregullimet e situatës financiare.
- 2.6. Ne rastet kur dega doganore me iniciativën e saj vendos revokimin/ndryshimin e vendimit te shpalljes debitor rregullimi i situatës financiare behet nga vete dega doganore duke bërë njoftimet si më sipër.
3. **Apelimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore për vendosjen e sanksioneve (në fushën e akcizës) sipas përcaktiveve te nenit 105 te ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.**
- 3.1. Debitori mund te ankohet kundër një vendimi për detyrimet e papaguara sipas përcaktiveve të nenit 105 te ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke plotësuar kushtet e detyrueshme ligjore:
- a) Ankimi te jete ushtruar brenda 30 ditëve nga data e njoftimit te vendimit (marrjes dijeni);
 - b) Debitori (apeluesi) duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimit të akcizës ne masën 100%;
 - c) Debitori (apeluesi) duhet të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e përgjithshme ne masën 100% të penaliteteve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti.
- Garantimi i penalitetit duhet të kryhet vetëm nga Bankat e Nivelit të Dytë dhe formati i kësaj garancie bankare duhet të jetë në përputhje me formatin e Aneksit 23 miratuar me VKM nr. 612, dt 05.09.2012 " Për Dispozitat Zbatuese të ligjit për akcizat", i ndryshuar.
- 3.2. Me paraqitjen e kërkesës ankimore, Drejtoria Juridike në DPD:
- a) Bazuar në konfirmimin e Degës Doganore (me shkresë dhe/ose e-mail), për datën ne te cilin debitori ka marre dijeni për vendimin/njoftim vendimin e

shpalljes debitor, verifikon nëse është respektuar afati 30 ditor për depozitimin e ankimit, i parashikuar ne nenin 105 të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë". Përllogaritja e afatit 30 fillon nga e dita e nesërme e marrjes dijeni nga subjekti debitor deri ne datën e depozitimit te kërkesës ankimore në DPD/Poste

- b) Ne rast se apeluesi është *ne tejkalim te afatit sipërcituar*, Drejtoria Juridike e konsideron të paezauruar rrugën administrative të ankimit të procedon me mosshqyrtimin/e ankimit/rekursit administrativ duke i kthyer përgjigje apeluesit për mosplotesimin te kushtëzimit te parashikuar ne nenin 105. Ne rastet kur ankimi ka bashkëlidhur garancisë për penalitetin, me kthimin e përgjigjes për mosplotesimin te kushtëzimeve ligjore, origjinali i garancisë i kalon Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit për te proceduar ne përputhje me nenin 105 për kalimin e garancisë për llogari te Drejtorisë se Përgjithshme te Doganave.
- c) Ne rastet kur apeluesi ka përbushur kushtëzimin e afatit te depozitimit te ankimit të vetëm pasi konfirmohet nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit apo nga Dega Doganore kryerja e pagesës 100% e detyrimit te Akcizës dhe pagesa/garantimi 100% i penalitetit dhe rezulton se garancia bankare e 100% të penalitetit është në përputhje me Aneksin 23 , Drejtoria Juridike procedon me tej.
- c) Çdo vendim marrje e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave i njoftohet apeluesit, Degës Doganore qe ka marre vendimin administrativ për shpalljen debitor, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, si dhe strukturave të tjera përfshirëse /konstatuese të shkeljes doganore.
- d) Pavarësisht draftit paraprak, Vendimi përfundimtar është në diskrecion të Drejtorit te Përgjithshëm dhe duhet te përbaje edhe te drejtën dhe afatin për ankim pranë autoriteteve gjyqësore.

3.3 Ne zbatim te pikës 5 te nenit 105, të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ne rast se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vendos rrëzimin e kërkesës ankimore (lihet ne fuqi vendimi i degës doganore) Drejtoria Juridike i përcjell origjinalin e garancisë të depozituar Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit e cila bën kalimin e menjëhershëm te shumes se garancisë ne llogarinë e DPD.

3.4 Ne rast se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vendos pranimin e ankimit/rekursit administrativ procedohet me shfuqizimin e vendimit te degës doganore dhe me rregullimin e pasojave financiare. Drejtoria e Financës procedon me çlirimin e garancisë dhe/ose kthimin e shumes se paguar ne zbatim e vendimit administrativ te shpalljes debitor.

3.5 Nëse Drejtori i Përgjithshëm vendos dërgimin e vendimit objekt ankimiadministrativ për rishikim pranë degës doganore përkatëse, pas rishikimit dega doganore njofton ne DPD, strukturën konstatuese të shkeljes dhe Drejtorine e Buxhetit dhe Financës duke dërguar një kopje te vendimit te rishikuar. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës bën rregullimet e situatës financiare.

3.6 Ne rastet kur dega doganore me iniciativën e saj vendos revokimin/ndryshimin e vendimit te shpalljes debitor rregullimi i situatës financiare behet nga vete dega doganore duke bërë njoftimet si më sipër.

XI. TE PERGJITHSHME

1. Administrata doganore përdor mënyrën më efikase dhe më të sigurtë për mbledhjen e shumës së detyrimeve të papaguara, nga ana e debitorit. Në asnjë rast administrata doganore nuk mbivlerëson një mënyrë kundrejt një tjetre, si dhe nuk përjashton ekzekutimin mbi disa grupe pasurish të debitorit kundrejt të tjerave. Ajo nxjerr njoftimin sipas të cilit për pasuritë e debitorit do të fillojnë procedurat ligjore për vënien në ekzekutim të tyre.
2. Sekuestroja vihet mbi sende, vlera e të cilave plotëson pagimin e detyrimit, gjobës, të kamatave e të shpenzimeve të bëra për ekzekutim.
3. Dega Doganore kryen sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme vetëm atëherë kur pasuria e luajtshme nuk mjafton për pagimin e detyrimit, gjobës, të kamatave e të shpenzimeve të bëra për ekzekutim.
4. Në rast se sendi i sekuestruar është i ndashëm dhe rezulton me një vlerë më të madhe nga ajo që kërkohet, ndahet prej tij aq sa është e nevojshme përmarrjen e detyrimit, gjobës e të detyrimeve të tjera dhe për shpenzimet e bëra, ndërsa diferenca i kthehet pronarit të sendit ose depozitohet në emër të tij.
5. Administrata doganore, nuk mund te sekuestrojë dhe të kalojë në favor të saj përfshirë shituri më vonë me qëllim arkëtimin e detyrimeve te papaguara pasuritë siç janë përcaktuar ne nenin 529 te Kodit te Procedurës Civile. Sipas këtij nenit administrata doganore nuk mund të sekuestrojë pasuritë e mëposhtme:
 - a) sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiliat për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
 - b) ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;
 - c) dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;
 - d) librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
 - e) deri 3 dynymë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtore;
 - f) ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përvçe kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;
 - g) frutat natyrore një muaj para se ato të piqen.
 - h) sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.

6. Shitia përmes procedurave te ankandit

- 6.1 Pasuria e konfiskuar, transportohet e depozitohet në magazinat/ambientet e përcaktuara për këtë qëllim, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ku i vihen plumbçet doganore.
- 6.2 Sendet e konfiskuara shiten nga Dega Doganore kompetente qe beri konfiskimin, sipas legjislativit ne fuqi për ankandin publik, me përjashtim të rastit kur Kodi Doganor apo ligji per Akcizat e parashikon ndryshe.
- 6.3 Sendet e konfiskuara për qëllime ankandi vlerësohen nga Komisione të Posaçme Vlerësimi për vlerësimin e pasurisë së sekuestruar, që ngrisen pranë Degëve Doganore, vlerë e cila shërben si vlerë fillestare për ankandin publik.
- 6.4 Procedura e ankandit kryhet nga Degët Doganore, sipas procedurave të përcaktuara në:
 - Ligjin Nr.9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar,
 - VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”,
 - Akte të tjera në fuqi, të zbatueshme nga autoritetet doganore, si dhe
 - Çdo akt që ndryshon këto akte në të ardhmen, të cilat zbatohen automatikisht nga administrata doganore.

XII. REVOKIMI I URDHrit TE SEKUESTRIMIT

1. Vendimi për ekzekutim forcërisht te mallit nëpërmjet sekuestrimit revokohet kur:
 - a) Detyrimet e papaguara dhe gjoba e zbatuar paguhet apo garantohen me pagesën përkatëse ne para;
 - b) Kur detyrimet e papaguara shuhen;
 - c) Kur ka një vendim gjyqësor te formës se prere ne favor te debitorit.

XIII. DISPOZITA TE PERBASHKETA PER TE DY RASTET E VJELJES ME FORCE TE BORXHIT DOGANOR (Dega Doganore dhe Përmbarimi)

1. Ne rastin kur autoritetet doganore apo përmbarimore kane mundësuar pagimin e detyrimeve te papaguara ne përputhje me nenin 282 te Kodit Doganor dhe nenit 103 te ligjit nr. 61/2012 ‘Për akcizat ne Republikën e Shqipërisë’, autoritetet doganore do te konsiderojnë se detyrimi i debitorit për te paguar detyrimet përkatëse është plotësuar nëse shuma e mbledhur i mbulon këto detyrime.
2. Nëse shuma e mbledhur mbulon vetëm një pjese te detyrimeve te papaguara, autoritetet doganore do te konsiderojnë se detyrimi i debitorit është plotësuar vetëm për atë pjese qe mbulohet nga shuma e siguruar përmes procedurave te vjeljes me force te borxhit.

XIV. SHUARJA E DETYRIMEVE TE PAPAGUARA

1. Procedurat e shuarjes se borxhit doganor behet sipas përcaktimes te neneve 109 -118 te Kodit Doganor, nenit 15 te ligjit nr. 61/2012 ‘Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë’ dhe te pikave 212-235 te Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor.

2. Zyra/Sektori i Administratës dhe Shërbimeve ne Degën Doganore administron praktiken e borxhit qe plotëson kushtet ligjore për t'u shuar.
3. Rastet me te përgjithshme kur detyrimet e papaguara mund te shuhen dhe debitori te hiqet nga lista përkatëse janë kur:
 - a) Vendimi i shpalljes debitor për detyrimet e papaguara është shfuqizuar nga DPD apo revokuar nga Dega e Doganës përkatëse.
 - b) Vendimi për detyrimet e papaguara është shfuqizuar me vendim gjyqësor te formës prere dhe pasi janë kryer te gjitha procedurat për kundërshtimin e tij sipas Udhëzimit te ministrit përgjegjës për financat ne lidhje me Buxhetin e Shtetit.
 - c) Detyrimet e papaguara është paguar apo rikuperuar nëpërmjet zbatimit te masave te rikuperimit forcërisht te borxhit .
 - ç) Mallrat para çlirimit te tyre sekuestrohen dhe njëkohësisht ose me vone konfiskohen, asgjësohen ose braktisen, humbasin ne mënyrë te pakthyeshme për shkaqe qe lidhen me vete natyrën e tyre ose me rrëthana te paparashikueshme ose për shkaqe fuqie madhore. Ne këtë rast shuhet vetëm borxhi doganor/akcizës.

XV. DOKUMENTACIONI PER DETYRIMET E PAPAGUARA

1. Ne përfundim te gjithë procedurës për evidentimin, kontabilizimin, njoftimin vjeljen dhe shuarjen e borxhit, dosja e Borxhit doganor/borxhit te akcizës dhe e detyrimeve qe duhen paguar duhet te përbajë dokumentat e mëposhtme:
 - a) Praktiken doganore dhe kopje te te gjithë dokumentacionit tregtar shoqërues, për të cilën pretendohet se ka lindur një borxh doganor/borxhi i akcizës;
 - b) Proces verbal konstatimi origjinal, te shoqëruar me te gjithë dokumentacionin qe provon se për praktiken ne fjale nuk janë paguar ne rregull detyrimet doganore/ detyrimet e akcizës;
 - c) Një raport nga konstatuesi ose Raportin paraprak apo përfundimtar (sipas rastit, ne varësi te procedurave respektive te secilit kontrollues), ku të tregohet saktësisht, rruga përmes se cilës ka lindur borxhi doganor/borxhi i akcizës, koha e lindjes se tij, përcaktimin e debitor-it/eve, elementet e taksimit ne momentin e lindjes se këtij borxhi doganor/akcizës, shumen e përllogaritur te borxhit doganor/akcizës si dhe përllogaritjen dhe shumen e penaliteteve (sanksioneve) respektive sipas Titullit IX te Kodit Doganor dhe Kreut XII shkeljet ne fushën e akcizës sipas ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë";
 - d) Proses verbale të tjera të mbajtur për shkeljen doganore/të akcizës, sipas përcaktimeve në Kodin Doganor dhe ligjin për Akcizat;
 - e) Vendimin e kryetarit te Degës Doganore respektive ku përcaktohet borxhi doganor/borxhi i akcizës dhe detyrimet e tjera qe duhen paguar;
 - dh) Njoftimin e debitorit për vendimin;
 - e) Vendimin e kryetarit te Degës Doganore respektive për masat shtrënguese për garantimin dhe ose rikuperimin forcërisht te borxhi doganor/borxhit te akcizes dhe detyrimet e tjera qe duhen paguar;
 - ë) Njoftimi i debitorit, i kunderfimosur ose njoftimi dhe konfirmimi i postes për dorëzimin e njoftimit tek subjekti. Ne rast se njoftimi është bere me shpallje një kopje e shpalljes;
 - f) Mandat pagesat sipas rastit;
 - g) Kërkesa drejtuar Gjykatës për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit;

- gj) Urdhri i Ekzekutimit nga Gjykata / masa e sigurisë për mos marrjen e asnje mase tjetër sigurie për ekzekutimin e borxhit doganor/borxhit te akcizës;
- h) Lajmërimi i debitorit për ekzekutim vullnetar të Urdhrit të Ekzekutimit;
- i) Urdhri i sekuestros, nëse ka, shoqëruar me gjithë praktiken për administrimin e gjithë procedurës;
- j) Kërkesën për ekzekutim tek përmbarimi gjyqësor (nëse ka);
- k) Vendimin për shuarjen e borxhit, ne rastet e shuarjes se tij, te shoqëruar me dokumentacionin përkatës (propozime, akt-konstatime, vendime te gjyqësorit te formës se prere, etj.);
- l) Akte të Bankave, të Zyrave të Regjistrimit të Pasurisë të Luajtshme, të Zyrës së Regjistrimit te Pasurisë se Patundshme për pasurinë e patundshme te vendosur si garanci apo si objekt sekuestrimi ;
- ll) Proces verbale dhe dokumenta te tjera qe kane te bëjnë me zbatimin e masave te sekuestrimit dhe konfiskimit te mallrave.

XVI. AKTE QE SHFUQIZOHEN

Udhëzimi nr.6, date 07.04/2016 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës” shfuqizohet.

XVII. HYRJA NE FUQI

Ky udhëzim hyn ne fuqi menjëherë.

XVIII. ANEKSET ME FORMULARËT TIP

Ky Udhëzim ka bashkëlidhur anekset me formularët tip, te cilët konsiderohen pjese përbërëse e tij dhe janë te detyrueshëm për t'u përdorur me hyrjen ne fuqi te këtij Udhëzimi.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE

Adresa:

Tel/Fax

Nr. _____ Prot

Date _____ / _____ /

NJOFTIM VENDIMI

Drejtuar: Shoqërisë _____

Adresa: _____

Ne zbatim te Ligjit nr.102, date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar; VKM Nr.651, datë 10.11.2017 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor"; Ligjet nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

Ju njoftojme se:

Ne vijim te verifikimeve te kryera nga autoritetet doganore eshte konstatuar:

- Nje diferenca ne vlore / sasi/ cilesi/ origjine
- falsifikimi i faturave te importit nr. _____ te _____ leshuar nga _____, nga te cilat IMP nr. _____ eshte nenshkruar nga agjenti doganor
- Kryerje kontrabande;
- Te tjera (specifikimi) _____
- Shkelje në fushën e akcizës;

Per keto arsyen:

Shoqeria juaj me vendimin nr._____, date ____/____/____(bashkengjitur) eshte shpallur debitore per:

- shumen _____ leke ne forme detyrimi doganor/të akcizës;
- shumen _____ leke ne forme sanksionesh, plus
- kamat vonesa _____ leke ne favor te Administrates Doganore.

Sa me siper kerkohet paraqitja juaj prane Deges Doganore brenda _____ diteve nga marrja e njoftimit per ekzekutimin vullnetar te vendimit te sipercituar, ne te kundert Administrata Doganore do te ndermarre procedurat ligjore per rikuperimin me force te detyrimeve te papaguara.

Kryetari i Deges Doganore

Nje kopje e kesaj letre eshte dorezuar me date _____ prane Qendres se Shoqërisë dhe agjentit doganor te permendor ketu me siper dhe nje kopje në adresën elektronike të depozituar nga shoqëria juaj

	Marresi nuk gjendet Shkresa e njoftimit u dorezua:	Marresi/ personat e tjere te percaktuar nga ligji refuzojne te nenshkruajne.
Firma e marresit (ose ne rastin e personit juridik e perfaqesuesit)	Firma e _____ (Shenoni lidhjen e ketij personi me marresin)	Nepunesi qe ben njoftej / deshmitari Nepunesi qe ben njoftej/ deshmitari _____



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE

Adresa:

Tel/Fax

Nr. _____ Prot

Date _____ / _____ / _____

KERKESE
PER LESHIM TE URDHRIIT TE EKZEKUTIMIT

KERKUESI: Dega Doganore _____

OBJEKTI: Leshim Urdhri Ekzekutimi per vendimin nr. _____ dt. _____ / _____ / _____ te
Duges Doganore _____ per zbatimin e masave garantuese
dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/të akcizës

BAZA LIGJORE : Neni 280 Kodit Doganor/neni 103 i ligjit 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise", neni 511 e ne vijim i K. Pr. Civile.

Drejtar: **GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR/ ADMINISTRATIVE**

Dega Doganore _____ me vendimin Nr. _____, datë _____ / _____ / _____ ka
vendosur për shoqërinë _____ të shpallet debitore per:

- shumen _____ ne leke ne forme detyrimi doganor/të akcizës;
- shumen _____ leke ne forme sanksionesh, si dhe
- kamat vonesat deri në ekzekutimin e detyrimeve të papaguara në shumën
_____ leke deri me datë _____ / _____ / _____.

Ky vendim i është njoftuar debitorit përmes _____.

Në kushtet kur nga debitori (nuk është ushtruar
ankim ndaj vendimit të Dëges Doganore, ankesa muk eshte marre ne shqyrtim nga DPD dhe debitori nuk ka
ushtruar ankim ne gjykate etj.) Dega Doganore ka nxjerrë Vendimin Nr. _____, datë
_____ / _____ / _____ "Për rikuperimin me Forçë të borxhit doganor/të akcizës", përmes të
cilit eshtë vendosur sekuestrimi i

(sasia,
lloji i mallit, vendndodhja).

Ky vendim i është njoftuar debitorit dhe në baze te pikes 5 te nenit 280 te Kodit
Doganor /nenit 103 te ligjit 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise" është
kthyer në Titull Ekzekutiv.

Meqenese vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/të akcizës nuk është ekzekutuar ne menyre vullnetare nga subjekti debitor dhe nuk ka asnjë shkak ligjor per te penguar ekzekutimin e tij, mbeshtetur ne nenin 511 e ne vijim te Kodit te Procedures Civile, dhe te pikes 5 te nenit 280 te Kodit Doganor,

KERKOJME:

Leshimin e Urdherit te Ekzekutimit per ekzekutim ne menyre te detyrueshme te vendimit nr. _____ dt ____ / ____ / ____ drejtperdrejt nga Dega Doganore _____ si dhe nga Zyra e Permbarimit.

Bashkelidhur keni:

- Vendimin nr _____ dt ____ / ____ / ____ te Deges Doganore per detyrimet e papaguara.
- Njoftimin e Vendimit nr _____ dt ____ / ____ / ____ .
- Vendimin nr _____ dt ____ / ____ / ____ te Deges Doganore per marrjen e masave garantuese
dhe/ose per Rikuperimin me force te borxhit doganor/te akcizes;
- Njoftimin e Vendimit nr _____ dt ____ / ____ / ____ per Rikuperimin me force.

Kryetari i Degës Doganore



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE

Adresa: _____ *Tel./Faks:* _____
Nr. _____ *Prot.* _____, *me* _____ / _____ / _____

LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR
TË URDHRIIT TË EKZEKUTIMIT

Drejtuar: _____
Për dijeni: _____

Gjykata e Rrethit Gjyqësor/Administrative _____ me vendimin “Për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit” nr. _____ Akti, datë _____ / _____ / _____, me palë:

Kreditor: Dega Doganore _____
Debitor: _____

Objekti: Kërkesë për lëshim të urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. _____ Akti, datë _____ / _____ / _____ të Degës Doganore _____.

ka vendosur lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv vendimit Nr. _____, datë _____ / _____ / _____ të Degës Doganore _____ për rikuperimin me forcë të borxhit.

Përmes këtij vendimi, Gjykata ka vendosur:

1. _____
2. _____
3. _____

Në mbështetje të nenit 280 të Kodit Doganor/nenit 103 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 511 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, Ju lajmërojmë për ekzekutim vullnetar brenda 10 ditësh, të detyrimit që përban vendimi nr. _____, datë _____ / _____ / _____, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor/Administrative _____.
Për këto arsy, në mbështetje të nenit 280 të Kodit Doganor/nenit 103 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 511 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile,

URDHËROJ:

1. Kryerjen e ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. _____ Akti, date _____ / _____ / _____, në mënyrë vullnetare brenda 10 ditësh, duke filluar ky afat nga data e marrjes dijeni, për shumat e mëposhtme:

- a) Detyrimet totale të papaguara në shumën _____ lekë.
- b) Kamatë vonesat në shumën _____ lekë..
- c) Shpenzime të tjera për ekzekutimin në shumën _____ lekë që i ngarkohen debitorit.

Në total, Ju detyroheni të paguani shumën _____ lekë në favor të palës kreditore.

2. Derdhja e shumës do të kryhet në llogarinë _____ te Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
3. Në rast se ekzekutimi nuk kryhet në mënyrë vullnetare brenda 10 ditësh, në bazë të nenit 245 pikat 2 dhe 4 të Kodit Doganor, Dega Doganore _____ është e detyruar dhe do te procedoje përmes ekzekutimit të detyrueshëm.

Kryetar i Degës Doganore
(emer, mbiemer, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE

Adresa: _____

Tel./

Faks: _____

Nr. _____ Prot. _____, me _____
/ ____ / _____

URDHËR PËR VENDOSJE SEKUESTRO EKZEKUTIVE

Kreditor: Dega Doganore _____

Debitor: Shoqëria _____ me Nipt _____

Objekti: Sekuestrim i _____ për shumën lekë.

Drejtuar: _____

Për dijeni: Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Baza ligjore: nen 280 i Kodit Doganor/neni 103 i ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nen 519 i Kodit të Procedures Civile, nen 34 i ligjit Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”,

Sot, me datën ____ / ____ / ____ , unë _____ Kryetar i Degës Doganore _____, pasi studiova praktikën doganore nr. _____, datë ____ / ____ / ____ , që kishte të bënte me kundravajtje doganore/akcizës të kryer nga shoqëria _____, në zbatim të vendimit “Për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit” nr. _____ Akti, datë ____ / ____ / ____ , të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor /Administrative_____.

KONSTATOVA:

Se, janë plotësuar kushtet ligjore për ekzekutimin forcërisht të Titullit Ekzekutiv, vendimit Nr. _____, datë ____ / ____ / _____, "Për rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës" të Degës Doganore _____, sipas përcaktimeve të nenit 280 të Kodit Doganor/nenit 103 të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 511 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, nenit 32 e në vijim të ligjit Nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" për detyrimet e papaguara nga ana e shoqërisë.

Subjekti debitor nuk ka pranuar ekzekutimin vullnetar të detyrimeve të papaguara të vendosura me vendimin Nr. _____, datë ____ / ____ / _____, të Degës Doganore _____.

Për sa më lart, në bazë të nenit 280 të Kodit Doganor/nenit 103 të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 511 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, nenit 32 e në vijim të ligjit Nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative",

URDHËROJ:

1. Sekuestrim Ekzekutiv të palës debitore, shoqërisë _____ me Nipt _____ :

a) në llogarinë (vlera monetare, kreditë, sendet me vlerë, valutë që është depozituara në Bankë _____ kur ka një gjëndje të tillë)

(ne pjesen e lene bosh vendoset objekti që sekuestrohet)

për ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. _____, datë ____ / ____ / _____, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor/Administrative _____ në shumën totale _____ lekë, e cila përbëhet nga _____ lekë detyrime për t'u paguar dhe kamatë vonesa deri në datën _____ e likuidimit në shumën _____ lekë të llogaritura dhe kalimin e gjithë shumës në favor të Degës Doganore _____, në numrin e llogarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave _____.

2. Personat që bëhen pengesë apo që refuzojnë të ekzekutojnë detyrimin kanë përgjegjësi sipas ligjit.
3. Ky urdhër është i formës së prerë.
4. Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve.

Kryetar i Degës Doganore
(emer, mbiemer, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Financave dhe Ekonomise
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE

Adresa:

Tel/Fax

Nr. _____ Prot

Date _____ / _____ / _____

NJOFTIM

**VENDIMI Nr. _____, datë _____ / _____ / _____
PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR/AKCIZËS**

Drejtuar: Shoqerise _____

Adresa: _____

Ne zbatim te Ligjit nr.102, date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar; VKM Nr.651, datë 10.11.2017 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor"; Ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

Ju njoftojme se:

Dega Doganore _____ me vendimin Nr._____, datë _____ / _____ / _____ ka vendosur për shoqërinë _____ të shpallet debitore per:

- shumen _____ ne leke ne forme detyrimi doganor;
- shumen _____ leke ne forme sanksionesh, si dhe
- kamat vonesat deri në ekzekutimin e detyrimeve të papaguara në shumën _____ leke deri me datë _____ / _____ / _____.

Ky vendim Ju është njoftuar përmes _____. Në kushtet kur nga ana Juaj (*nuk është ushtruar ankrim ndaj vendimit të Degës Doganore, nuk eshte marre ne shqyrtim nga DPD ankesa Juaj dhe nuk keni ushtruar ankrim ne gjykate etj.*), Dega Doganore në zbatim të nenit 280 te Kodit Doganor / nenit 103 te ligjit 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise" ka nxjerrë Vendimin Nr._____, datë _____ / _____ / _____ "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/të akcizës".

Përmes vendimit Nr._____, datë _____ / _____ / _____ "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/borxhin e akcizes", Dega Doganore ka vendosur, si me poshte:

1. Sekuestrimin e vlerave monetare, kredivë, sendeve me vlerë të çmuar, dokumentave me anë të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në banka, që i përkasin debitorit, _____ personave të tretë ose garantuesve që kanë detyrime kundrejt debitorit;
2. Sekuestrimin e mallrave, pasurive të tundshme ose të patundshme që i përkasin debitorit _____ ose një pale të tretë ose garantuesit që ka detyrime kundrejt debitorit.

3. Kryerjen e sekuestrit të mësipërm deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve për t'u paguar nga subjekti debitor _____, të përcaktuara me vendimin Nr._____, datë ____ / ____ / _____, në shumën _____ lekë, si dhe kamatë vonesat e lindura sipas nenit _____ të Kodit Doganor/ligjit të akcizës në masën _____ % të vlerës së borxhit për cdo ditë vonesë, nga data e njoftimit të debitorit, deri në datën e likujdimit të të gjitha detyrimeve të papaguara.

Kryetari i Deges Doganore

Nje kopje e ketij njoftimi eshte dorezuar me date ____ / ____ / ____ prane Qendres se Shoqerise importuese dhe agjentit doganor te permendor ketu me siper.

Firma e marresit (ose ne rastin e personit juridik e perfaquesuesit)	Marresi nuk gjendet Shkresa e njoftimit u dorezua:	Marresi/ personat e tjere te percaktuar nga ligji refuzojne te nenshkruajne.
	Firma e _____ (Shenoni lidhjen e ketij personi me marresin)	Nepunesi qe ben njoftimin / deshmitari Nepunesi qe ben njoftimin/ deshmitari _____



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE

Adresa: _____

Tel./Faks: _____

Nr. _____ Prot. _____, me _____ / _____ / _____

**LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR
TË URDHrit TË EKZEKUTIMIT**

Drejtuar: _____

Për dijeni: _____

Gjykata e Rrethit Gjyqësor /Administrative _____ me vendimin “Për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit” nr. _____ Akti, datë _____ / _____ / _____, me palë:

Kreditor: Dega Doganore _____

Debitor:

Objekti: Kërkesë për lëshim të urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. _____ Akti, datë _____ / _____ / _____ të Degës Doganore _____.

ka vendosur lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv vendimit Nr. _____, datë _____ / _____ / _____ të Degës Doganore _____ për rikuperimin me forcë të borxhit.

Përmes këtij vendimi, Gjykata ka vendosur:

1. _____
2. _____
3. _____

Në mbështetje të nenit 280 të Kodit Doganor/nenit 103 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 511 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, Ju lajmërojmë për ekzekutim vullnetar brenda 10 ditësh, të detyrimit që përmban vendimi nr. _____, datë _____ / _____ / _____, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____.

Për këto arsy, në mbështetje të nenit 280 të Kodit Doganor/nenit 103 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 511 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile,

URDHËROJ:

4. Kryerjen e ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. _____ Akti, date _____ / _____ / _____, në mënyrë vullnetare brenda 10 ditësh, duke filluar ky afat nga data e marrjes dijeni, për shumat e mëposhtme:

- d) Detyrimet totale të papaguara në shumën _____ lekë.
- e) Kamatë vonesat në shumën _____ lekë..
- f) Shpenzime të tjera për ekzekutimin në shumën _____ lekë që i ngarkohen debitorit.

Në total, Ju detyroheni të paguani shumën _____ lekë në favor të palës kreditore.

5. Derdhja e shumës do të kryhet në llogarinë _____ te Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
6. Në rast se ekzekutimi nuk kryhet në mënyrë vullnetare brenda 10 ditësh, në bazë të nenit 280 pikat 2 dhe 3 të Kodit Doganor, Dega Doganore _____ është e detyruar dhe do te procedoje përmes ekzekutimit të detyrueshëm.

Kryetar i Degës Doganore
(emer, mbiemer, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE

Adresa: _____

Tel./

Faks: _____

Nr. _____ **Prot.** _____, me _____ / _____ / _____

PROCES VERBAL SEKUESTRIMI

Mbajtur me datë _____ / _____ / _____ në ambjentin e Shoqerise
me adresë _____

Nga punonjësit doganorë:

- | | | |
|----------|-----------|-------|
| 1. _____ | me detyrë | _____ |
| 2. _____ | me detyrë | _____ |
| 3. _____ | me detyrë | _____ |
| 4. _____ | me detyrë | _____ |
| 5. _____ | me detyrë | _____ |

Në praninë e personave:

- | | | | |
|------------------|----------|----------|---|
| 1. _____ | me | cilësinë | e |
| 2. _____ | me | cilësinë | e |
| cilësinë e _____ | 3. _____ | | |
| me | cilësinë | e | |
| 4. _____ | me | cilësinë | e |
| 5. _____ | me | cilësinë | e |
| cilësinë e _____ | | | |

Ky proces verbal mbahet për sekuestrimin e sendeve të luajtshme/ të paluajtshme që i përkasin debitorit Shoqërise _____ me Nipt _____, në bazë të nenit 280 të Kodit Doganor/nenit 103 të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 511 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, nenit 32 e në vijim të ligjit Nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", në zbatim të vendimit nr._____, datë _____ / _____ / _____ për kalimin menjeherë në ekzekutim të detyrueshëm, Urdhrit të Ekzekutimit Nr. _____, datë _____ / _____ / _____, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor/Administrative _____ në shumën _____ lekë, dhe kamatë vonesat përkatëse të llogaritura deri me datën _____ / _____ / _____ në shumën _____ lekë, urdhrit të sekuestros ekzekutive nr._____, datë _____ / _____ / _____ si dhe pas verifikimit të pronësisë së debitorit mbi këto pasuri, sipas informacionit të marrë nga

____ (ketu jepen informacione nga institucionet, etj. për pronësinë e debitorit).

Sendet të cilat sekuestrohen janë:

Nr .	Përkrimi i sendeve që sekuestrohen	Informacion shtese per identifikim sendi	sasi				
1.							
2.							
3.							
4.							

Punonjësit doganorë të pranishëm në mbajtjen e procesverbalit të sekuestrimit dhe inventarizimit të pasurisë, kryejnë veprimet si vijon:

(Këtu përkruhen, përvèc të tjerave edhe veprimet për plumbosjen dhe transportimin e sendeve (në rastet kur kjo është e mundur) në ambientet e përshtatshme, personat dhe vendin ku lihen apo dergohen për ruajtje sendet e sekuestruara, etj.)

Veprimet, kërkesat dhe deklarimet e debitorit dhe personave të pranishëm:

Shënime të tjera të vlefshme:

Per Degen Doganore

Per Drejtore e Antikontrabandes

Refuzoi firmën:

